

Prishtinë: 12.07.2007
Kodi i ZRrE-së: D_060_2007
Nr. i Referencës ERO/CPD_D_21_06_07

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Ligjin Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës;
4. Apelimin e konsumatorit kundër parapagimit për RTK;
5. Përgjigjen e KEK-ut me numër të referencës DPR – CO1 – 03 të datës 03.03.2007 në ankesën e konsumatorit për parapagimin për RTK;
6. Ankesën e bërë nga konsumatori i lartpërmendur në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në Zyrën e Rregullatorit për Energji me datë 08.05.2007 e me numër regjistrimi 60/05 2007;
7. Vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE lëshuar konsumatorit me datë 11.06.2007
8. Parashtrimin nga ana e konsumatorit të kundërshtimit të vendimit të lëshuar nga DMK në ZRrE, drejtuar Bordit të ZRrE-së me datë 28.06.2007
9. Dispozitat e Nenit 18 të Rregullit mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në seancën e mbajtur më 11.07.2007 nxjerrë këtë vendim:

VENDIM

REFUZOHET apeli i konsumatorit z. Rashit Lladrovci kundër vendimit të DMK për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi

Arsyetim

1. Konsumatori ka bërë ankesë ndaj KEK Sh.A-së lidhur me parapagimin për Radiotelevizionin e Kosovës.
2. Më 03.03.2007 KEK SH.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij lidhur me parapagimin për RTK duke u bazuar në Ligjin Nr. 02/L-47 për Radio Televizionin e Kosovës.

3. Më 08.05.2007 konsumatori në ankesën e tij numër regjistrimi 60/05 2007, i është drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE duke apeluar përgjigjen e KEK-ut të datës 03.03.2007, ku kërkon që të mos e paguaj parapagimin për RTK.
4. Më 11.06.2007 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në ZRrE ka refuzuar apelimin e konsumatorit për shkak të këtyre arsytiveve:
 - 4.1 Konsumatori ka bërë ankesë ndaj KEK Sh.A-së lidhur me parapagimin për radio Televizionin e Kosovës.
 - 4.2 Me datë 03 mars 2007 KEK SH.A në përgjigjen e tyre dhënë konsumatorit shpjegon se parapagimi për RTK është i bazuar në Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës dhe se KEK-u ka shpjeguar se çdo shtëpi, biznes, ndërmarrje apo institucion tjetër në Kosovë është i obliguar sipas ligjit që të paguajë parapagimin për RTK.
 - 4.3 Me datë 08.05.2007 konsumatori në ankesën e tij nr. 60/05 2007, i është drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE duke apeluar përgjigjen e KEK-ut të datës 3 Mars 2007, ku kërkon që të mos e paguaj parapagimin për RTK.
 - 4.4 Në bazë të nenit 20.4 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike.
 - 4.5 Sipas nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 të liruar nga obligimi i cekur me lartë, përfshihen banorët e vendbanimeve ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës ku mungon sinjali cilësor televiziv i rrjetit tokësor, dhe Familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori e veçantë përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale.
 - 4.6 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve i ZRrE-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit të lartëcekur drejtuar ZRrE-së, përgjigjen e KEK-ut dhënë konsumatorit, dhe duke u bazuar në Legjislacionin e Aplikueshëm në Kosovë, konstaton se përgjigja e KEK-ut dhënë konsumatorit ishte në pajtim me legjislacionin në fuqi, për arsye se: konsumatori Rashit Lladrovci nuk i ka plotësuar kushtet e neneve 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radio televizionin e Kosovës, andaj **refuzon** ankesën e konsumatorit si të pabazë.
5. Më 28.06.2007 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e Vendimit D_21_06_07 dhënë nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK), në Bordin e ZRrE-së.
6. Më 11.07.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur një sesion dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur të refuzoj konsumatorin për shkak të arsytiveve të paraqitura në pikën 4 të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, konsumatori ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjyqin Kompetent të Prishtinës, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti

Anëtarët e Bordit:

Naim Bejtullahu

Theranda Beqiri

Nysret Avdiu